



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 27.04.2020)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e programit kompjuterik “Microsoft Teams” që mundëson ndërlidhjen audio-vizive në distancë për zhvillimin e seancave gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së epidemisë”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:00 dhe mbaroi në orën 14:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 7. Ilir Toska** (anëtar)
- 8. Alban Toro** (anëtar)
- 9. Brikena Ukperaj** (anëtar)

10. Erjon Muharremaj (anëtar)

11. Marçela Shehu (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Përfaqësues të misioneve mbështetëse.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e programit kompjuterik “Microsoft Teams” që mundëson ndërlidhjen audio-vizive në distancë për zhvillimin e seancave gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së epidemisë”.

Mbledhja plenare e datës 27 prill 2020 fillon me prezantimin e tre pikave të rendit të ditës nga Kryetarja e Këshillit, zonja Naureda Llagami dhe më pas i jep fjalën zotit Erjon Muharremaj për relatimin e çështjes e parë.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Erjon Muharremaj.

Merr fjalën zoti Erjon Muharremaj i cili lexon relacionin shpjegues lidhur me përmbajtjen e projektvendimit “Për miratimin e programit kompjuterik “Microsoft Teams” që mundëson ndërlidhjen audio-vizive në distancë për zhvillimin e seancave gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së epidemisë”.

Ndër të tjera, Komisioni i Përkohshëm për hartimin, propozimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të një plani masash për ushtrimin e veprimtarisë e shërbimeve gjyqësore në mënyrën më të sigurt të mundshme gjatë kohëzgjatjes së epidemisë së shkaktuar nga virusi Covid-19 i propozon Këshillit miratimin e përdorimit të programit kompjuterik “Microsoft Teams”, për të siguruar ndërlidhjen audio-vizive në distancë për zhvillimin e seancave gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së epidemisë, duke garantuar kështu mbrojtjen efektive dhe të drejtat e të paraburgosurve/dënuarve të cilët mund të komunikojnë privatisht nëpërmjet telefonit (i cili duhet të mundësohet nga gjykata) me përfaqësuesit

ligjorë që ndodhen në sallën e gjyqit.

Në relacion përshkruhen të gjitha avantazhet dhe mënyra e përdorimit të kësaj platforme, e cila ka standarde të larta sigurie dhe aktualisht po përdoret edhe nga vetë Këshilli për të realizuar mbledhjet e tij plenare si dhe mbledhjet e komisioneve.

Sa i përket detyrimeve financiare, zoti Muharremaj sqaron se përdorimi i kësaj platforme nuk do të sjellë kosto shtesë për Këshillin, pasi licencimi për përdorimin e kësaj platforme do të financohet nga Misioni EURALIUS V. Gjithashtu, mund të ofrohet mbështetje teknike nga ekspertët IT të EURALIUS.

Anëtarët e Këshillit për këtë çështje të rendit të ditës nuk kanë diskutime, pyetje apo sugjerime, prandaj hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit propozimi i Komisionit të Përkohshëm mbi projektvendimin “Për miratimin e programit kompjuterik “Microsoft Teams” që mundëson ndërlidhjen audio-vizive në distancë për zhvillimin e seancave gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së epidemisë”, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Illir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas propozimit të Komisionit të Përkohshëm për hartimin, propozimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të një plani masash për ushtrimin e veprimtarisë e shërbimeve gjyqësore në mënyrën më të sigurt të mundshme gjatë kohëzgjatjes së epidemisë së shkaktuar nga virusi Covid-19, vendosi miratimin e

projektvendimit “Për miratimin e programit kompjuterik “Microsoft Teams” që mundëson ndërlihdjen audio-vizive në distancë për zhvillimin e seancave gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së epidemisë”.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 27.04.2020)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projekt-udhëzimit “Për përcaktimin e masave për kufizimin e përhapjes së Covid-19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë gjyqësore dhe administrative në gjykata”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:00 dhe mbaroi në orën 14:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)

10. Erjon Muharremaj (anëtar)

11. Marçela Shehu (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Përfaqësues të misioneve mbështetëse.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projekt-udhëzimit “Për përcaktimin e masave për kufizimin e përhapjes së Covid-19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë gjyqësore dhe administrative në gjykata”.

Relatore e kësaj çështjeje është zonja Naureda Llagami.

Merr fjalën zonja Naureda Llagami e cila relaton shkurtimisht relacionin shpjegues lidhur me përmbajtjen e projektvendimit “Për përcaktimin e masave për kufizimin e përhapjes së Covid-19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë gjyqësore dhe administrative në gjykata”.

Duke qenë se tashmë gjykatat kanë filluar një pjesë të aktivitetit të tyre të punës konform aktit normativ, është gjykuar nga Komisioni i Përkohshëm për hartimin, propozimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të një plani masash për ushtrimin e veprimtarisë e shërbimeve gjyqësore në mënyrën më të sigurt të mundshme gjatë kohëzgjatjes së epidemisë së shkaktuar nga virusi COVID-19 (më tej Komisioni i Përkohshëm) që të miratohet në Këshill një projekt-udhëzim orientues lidhur me masat konkrete që duhet të marrin gjykatat gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre. Udhëzimi është strukturuar me kapituj duke parashikuar rregulla të higjienës (dezinfektimi etj.) dhe distancimit social dhe rregulla të karakterit organizativ dhe administrativ. Një ndër masat orientuese për fillimin e punës në gjykata është edhe puna me staf të reduktuar, duke u ruajtur kështu distanca 2m në sallat e gjyqit ashtu edhe në gjykatë.

I vetmi diskutim sa i përket këtij projektvendimi qëndron në faktin nëse duhet të qëndrojnë pika 2 në dispozitat e përgjithshme dhe zonja Kadi është e mendimit që kjo pikë të qëndrojnë dhe të kihet në konsideratë që në çdo rast, procesi i rregullt dhe ligjor nuk duhet të cenohet dhe që kjo situatë është e përkohshme.

Zonja Llagami jep një sugjerim mbi strukturimin e aspektit të teknikës legislative, pikërisht pas pikës 6, pjesa që është me *bold* të jetë pikë më vete.

Anëtarët e Këshillit për këtë çështje të rendit të ditës nuk kanë diskutime të tjera, pyetje, prandaj hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit propozimi i Komisionit të Përkohshëm mbi projektvendimin “Për përcaktimin e masave për kufizimin e përhapjes së Covid-19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë gjyqësore dhe administrative në gjykata”, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Illir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas propozimit të Komisionit të Përkohshëm për hartimin, propozimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të një plani masash për ushtrimin e veprimtarisë e shërbimeve gjyqësore në mënyrën më të sigurt të mundshme gjatë kohëzgjatjes së epidemisë së shkaktuar nga virusi Covid-19, vendosi miratimin e projektvendimit “Për përcaktimin e masave për kufizimin e përhapjes së Covid-19 gjatë

ushtrimit të veprimtarisë gjyqësore dhe administrative në gjykata”.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 27.04.2020)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i çështjes në lidhje me problematikën e adresuar nga Presidenti i Republikës me shkresën nr.1117/2 prot., datë 10.04.2020, “Mbi ndërprerjen e qëndrimit të mëtejshëm në detyrë të z. {...} si anëtar i Gjykatës së Lartë dhe kryesimin në vijim të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”, dhe relacionin e përgatitur për këtë qëllim nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, i ngarkuar me vendimin e Këshillit nr.140 datë 16.04.2020.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:00 dhe mbaroi në orën 14:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)

- | | |
|-----------------------------|------------------|
| <i>7. Ilir Toska</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>10. Erjon Muharremaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>11. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Përfaqësues të misioneve mbështetëse.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i çështjes në lidhje me problematikën e adresuar nga Presidenti i Republikës me shkresën nr.1117/2 prot., datë 10.04.2020, “Mbi ndërprerjen e qëndrimit të mëtejshëm në detyrë të z.{...} si anëtar i Gjykatës së Lartë dhe kryesimin në vijim të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”, dhe relacionin e përgatitur për këtë qëllim nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, i ngarkuar me vendimin e Këshillit nr.140 datë 16.04.2020.

Relatore e kësaj çështjeje është zonja Marçela Shehu.

Merr fjalën zonja Marçela Shehu e cila lexon relacionin shpjegues lidhur me trajtimin e problematikave të ngritura në shkresën e Presidentit të Republikës, shkresë të cilën Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi që ta trajtojë Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Ndër të tjera, në relacion parashtrohet e gjithë procedura e ndjekur deri më sot nga Këshilli i Lartë Gjyqësor lidhur me ngritjen dhe vënien në funksionim të Gjykatës së Lartë, duke nisur që nga:

Vendimmarrjet e Këshillit për hapjen e procedurave për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur (jogjyqtarët) me vendimet nr. 108, nr. 109 dhe nr. 110, datë 09.07.2019 dhe vendimi nr. 172, datë 11.09.2019,

ku në atë moment Gjykata e Lartë ka pasur në total 6 pozicione të lira dhe vetëm 3 prej tyre mund të plotësoheshin nga radhët e jogjyqtarëve;

Marrja nga Gjykata e Lartë e informacionit në lidhje me mandatet e 19 (nëntëmbëdhjetë) gjyqtarëve të saj, të emëruar në periudhën e fundit (në relacion janë të detajuara të dhënat mbi: emërimin, radhët nga të cilat ata ishin emëruar (gjyqtarë ose jogjyqtarë), si dhe përfundimin e mandatit të të anëtarëve të Gjykatës së Lartë);

Përfundimi i procedurave për 3 pozicione të lira, të shpallura për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur (jogjyqtarëve), propozimet për të cilët i janë përcjellë për miratim Presidentit të Republikës dhe pas miratimit dhe bërjes së betimit para Presidentit në datën 13 mars 2020, tre gjyqtarët e rinj kanë nisur punën zyrtarisht (ndërsa për pozicionin e katërt të shpallur, Këshilli është ende në shqyrtim e sipër të procesit të verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidatit);

Plotësimi i trupës gjyqësore të Gjykatës së Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, duke u hapur procedurat për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për 6 pozicione të lira, 3 në fushën e së drejtës administrative dhe 3 në fushën e së drejtës civile.

Gjithashtu në relacion parashtrohet edhe një informacion sa i përket mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, z. {...} dhe vijimit të ushtrimit të detyrës nga ana e tij nga radhët e jogjyqtarëve. Sipas dispozitave ligjore, mandati i tij duhet të përfundonte më datë 24.02.2014 por në kushtet kur nuk pati një anëtar pasardhës, po sipas dispozitave ligjore ai vazhdoi të ushtrojë detyrën deri në emërimin e gjyqtarit pasardhës, dispozitë e cila në vitin 2016 nga Gjykata Kushtetuese është quajtur si e papajteushme me Kushtetutën dhe ku më pas gjyqtari në fjalë nuk mori pjesë në gjykimin e çështjeve në Gjykatën e Lartë.

Kjo situatë ligjore ndryshoi me miratimin e ligjit nr.76, datë 22.07.2016 ku në 5 të nenit 136 të Kushtetutës u parashikua se: “Gjyqtari i Gjykatës së Lartë qëndron në detyrë deri në emërimin e pasardhësit, përveç rasteve të parashikuara në nenin 139, paragrafi 3, nënparagrafët “c”, “ç”, “d” dhe “dh”, ligj i cili hyri në fuqi 2 ditë përpara hyrjes në fuqi të vendimit të Gjykatës Kushtetuese që

deklaronte si të papajtuëshëm me Kushtetutën paragrafin që lejonte vazhdimin e detyrës së anëtarit të Gjykatës së Lartë edhe pas mbarimit të mandatit. Pas kësaj situatë, gjyqtari ka rifilluar me gjykimin e çështjeve në Gjykatën e Lartë, duke vlerësuar se mund të qëndrojë në detyrë deri në emërimin e gjyqtarit pasardhës.

Më tej në relacion parashtrohet vlerësimi që ky Komision i ka bërë rastit në fjalë dhe duke mbajtur në konsideratë nenin 61 ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson se problematika e adresuar në shkresën e Presidentit të Republikës nuk lidhet me ndonjë nga kompetencat që Këshilli ushtron në mbledhje plenare apo me ndonjë vendimmarrje të caktuar të tij; vlerëson gjithashtu se mandati i tij si gjyqtar i Gjykatës së Lartë, ka përfunduar ligjërisht në vitin 2014 dhe lidhur me përfundimin e këtij mandati është njoftuar Presidenti i Republikës sipas ligjit të kohës; vlerëson më tej se i përket KLGJ-së të vlerësojë dhe të vendosë nëse duhet të mbajë një qëndrim lidhur me ligjshmërinë e vijimit të ushtrimit të detyrës nga ana e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, mandati i të cilit ka mbaruar si dhe të vlerësojë nëse me emërimin e tre gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë, zotit {...} i ka mbaruar detyrimi kushtetues i qëndrimit në detyrë deri në emërimin e pasardhësit.

Ndaj, çështjet objekt diskutimi nga ana e Këshillit vlerësohet të jenë:

1. A i ka mbaruar zotit {...} detyrimi për të qëndruar në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Lartë deri në emërimin e pasardhësit?
2. Në hipotezën që ky detyrim i ka mbaruar, në situatën që zoti {...} vijon të qëndrojë në detyrë, a është Këshilli autoriteti që ka kompetencën për zgjidhjen e këtij ngërçi?
3. Nëse po, cila është mënyra e veprimit të Këshillit?
4. A mund të jetë një vendimmarrje një mënyrë veprimi nga Këshilli?
5. Nëse po, cila vendimmarrje e Këshillit i përgjigjet situatës konkrete?
6. Nëse jo, cila mund të jetë forma e veprimit nga Këshilli?

Diskutime/Komente/Pyetje/Propozime mbi çështjen

Në cilësinë e relatores, *zonja Shehu* jep vlerësimin e saj lidhur me çështjet që

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka parashtruar në relacionin e tij.

Siç u citua edhe në relacion, mandati i zotit {...} ka përfunduar në vitin 2014 dhe pas këtij momenti, zoti {...} ka vijuar të ushtrojë detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Lartë, bazuar në detyrimin ligjor e më pas Kushtetues, për të pritur gjyqtarin pasardhës të tij.

Në vlerësimin e zonjës Shehu, me emërimin e tre gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë, nga radhët e jo gjyqtarëve, zotit {...} i ka mbaruar detyrimi kushtetues për të vijuar ushtrimin e funksionit të gjyqtarit të GJL deri në emërimin e pasardhësit, pasi siç është cituar në relacion, 3 gjyqtarët e emëruar mund të zëvendësojnë potencialisht çdo mandat të mëparshëm nga radhët e gjyqtarëve. Gjithashtu, mbarimi i detyrimit kushtetues të gjyqtarit {...}, për të vijuar ushtrimin e funksionit të tij në Gjykatën e Lartë, nuk e lidh Këshillin me detyrimin për të disponuar me një vendim, qoftë ky vendim i karakterit substancial, qoftë ky një vendim i karakterit deklarativ apo konstatues, në kushtet kur një detyrim i tillë që lidhet me vendimmarrjen e Këshillit, nuk parashikohet në asnjë dispozitë ligjore apo kushtetuese, ndaj i vetmi veprim dhe reagim institucional dhe ligjor që duhet të marrë Këshilli në këtë rast është që t'i kërkojë zotit {...} të shprehë vullnetin lidhur me të drejtën që atij i njeh neni 62 i ligjit 96/2016 për t'u caktuar në një pozicion në nivel apeli, në kushtet kur detyrimi i tij kushtetues për të pritur gjyqtarin pasardhës tashmë ka përfunduar.

Pas fjalës së zonjës Shehu, merr fjalën **zonja Brikena Ukperaj** e cila propozon që subjekti i këtij procedimi administrativ duhet të paraqesë mendimin e tij me shkrim lidhur me çështjet e ngritura si propozim nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe i të njëjtit mendim është edhe **zoti Ilir Toska** i cili shprehet se tashmë Këshilli e ka filluar një proces administrativ, objekti i të cilit është nëse do duhet të vijojë zoti {...} të qëndrojë në detyrë deri në emërimet pasardhëse dhe çfarë duhet të ndodhë me zotin {...}. Ndërkohë Komisioni ka thënë që nuk duhet të ketë një vendimmarrje sepse Komisioni e ka pasur të paqartë vendimmarrjen që mund të merrte Këshilli. Gjithsesi, çdo lloj qëndrimi i Këshillit është një qëndrim që do të ketë efekte ndaj zotit {...}, prandaj zoti Toska mendon që zoti {...} duhet të dëgjohet, duke i referuar relacionin dhe duke dhënë opinion e tij lidhur me çështjen që është objekt diskutimi në Këshill. Ndërsa në lidhje me krahasimin që **zonja Brunilda Kadi** adreson si të njëjtë çështjen e zotit {...} ashtu si edhe rastet kur Këshilli

është shprehur për mbarimin e statusit të magistratëve për shkak të mbushjes së moshës së pensionit, duke mos thirrur në Këshill gjyqtarët, **zonja Ukperaj** përgjigjet që në ato raste ligji i ka sjellë efektet e tij dhe Këshilli vetëm shprehet. Ndërsa **zonja Kadi** është e mendimit që rastet janë të njëjta, ashtu si edhe është shprehur në mbledhjen e parë, mjafton që të verifikohet që gjyqtari i parë i Gjykatës së Lartë është betuar përpara Presidentit të Republikës, ka fillua të ushtrojë detyrën, dhe siç është shprehur ky Këshill në relacionin kur ka shpallur tre vendet, njëri nga tre vendet që u shpallën, i përkiste pozicionit të lirë të zotit {...}.

Në lidhje me propozimin e bërë nga zonja Ukperaj, **zonja Marçela Shehu** propozon që Këshilli të shprehet njëherë sa i përket vendimmarrjes, pra a do të shprehet Këshilli me vendimmarrje dhe nëse do shprehet me vendimmarrje, më pas t'i komunikohet zotit {...}, pasi vetë Komisioni ka propozuar që Këshilli nuk mund të disponojë me vendimmarrje për çështjen në fjalë.

Në lidhje me diskutimet, merr fjalën edhe **zoti Alban Toro** i cili shprehet se duke parë vakancat që janë plotësuar, në mënyrë kronologjike se si janë bërë emërimet e tre gjyqtarëve të rinj, rezulton që mandati i gjyqtarit {...} është konstatuar i mbaruar dhe ai vijon detyrën deri në momentin që të tre vakancat do të plotësoheshin. Të pyesësh zotin {...}, si rezulton përlllogaritja e tij, -i bie që së pari të kërkosh një vendim Këshilli në lidhje me statusin që ai ka, -shton zoti Toro. Sipas zotit Toro, nuk dihet nëse Këshilli do dalë me një vendimmarrje në fund sepse propozimi i Komisionit në thelb nuk është që Këshilli të marrë një vendim, mund të jetë edhe një rekomandim për zotin {...} që të largohet pasi të bëjë përlllogaritjet. Ndaj, e vetmja e drejtë e tij që mund të cenohet, do të ishte kur Këshilli do t'i cenonte të drejtën që atij i buron nga neni 62 i ligjit për Statusin. Momenti në të cilin ndodhet Këshilli është për efekt të plotësimit të tre pozicioneve të lira të Gjykatës së Lartë, të konstatohet mbarimin i vijimit të detyrës nga ana e gjyqtarit {...}.

Edhe **zonja Fatmira Luli** është e mendimit që ligji nuk parashikon një proces të tillë administrativ në rastet kur gjyqtarët zëvendësohen nga gjyqtari i ri. Opinioni i zonjës Luli është që vendi i tij është zëvendësuar dhe prandaj fillimisht Këshilli duhet të votojë

në lidhje me pasjen ose jo të një vendimmarrjeje nga ana e Këshillit dhe më pas të vijohet procedura sipas ligjit, duke i ofruar vendin që meriton në bazë të ligjit “Për statusin...”.

Pas diskutimeve hidhet fillimisht në votim propozimi i bërë nga zonja Ukperaj, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është kundër.

Brunilda Kadi është kundër.

Dritan Hallunaj është dakord.

Illir Toska është dakord.

Alban Toro është kundër.

Fatmira Luli është kundër.

Marçela Shehu është kundër, me arsyetimin e dhënë më sipër.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

(6 anëtarë janë pro propozimit të bërë nga zonja Ukperaj dhe 5 anëtarë janë kundër.)

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me shumicë votash pranoi sugjerimin e zonjës Ukperaj që t’i bëhet një komunikim zotit {...} për fillimin nga ana e Këshillit të kësaj procedure administrative, duke i bërë me dije gjithashtu çështjet që Këshilli do të marrë në diskutim dhe marrjen e opinionit nga ana e gjyqtarit. Pas marrjes së përgjigjes nga ana e zotit {...}, do të lihet sërish nga ana e Këshillit në rend dite diskutimi i kësaj çështjeje. Në vijim edhe të shqetësimit që ngriti zoti Toro në seancën plenare sa i përket nënshkrimit të Memorandumit, anëtarët e Këshillit vendosin një afat 2-ditor për përgjigjen e zotit {...}.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor